- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit]**, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti), nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomike më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti kontraktor përllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date;
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	cmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

1. Tavolinë për nxënësit - Përmasat të jenë 120x75x45 cm.

- Suprina MDF e melaminuar dhe e frezuar perimetralisht duhet të ketë trashësinë më të madhe ose të barabartë me 18 mm, me veshje laminatë në mënyrë që të durojë gërvishtje.
- Montimi i suprinës me skeletin duhet të bëhet me vida të fshehta ose me preçina me kokë Ø4. Në pjesën e poshtme të saj të jenë të vendosura një element me përmasa 110 x 26 cm MDF e melaminuar 16 mm dhe e frezuar perimetralisht, që shërben për mbajtje të librave të nxënësve.
- Në pjesën balllore të vendoset një element me përmasa 110 x 14.5 cm, me material MDF e melaminuar dhe e frezuar perimetralisht. Këmbët vertikale duhet të jenë me profil tubular oval ku në të dyja anët e tubit të jetë i rrumbullakosur, që të japë fortësinë dhe imazhin e dukshëm të tavolinës, me seksion jo më të vogël 50 x 25 mm dhe spesor jo më të vogël se 1.2 mm.
- Pjesa fundore do të jetë me profil tubularoval ku në të dyja anët të rrumbullakosur jo më të vogël se 50 x 25mm, me spesor jo më të vogël se 1.2 mm.

- Pjesa e harkut, duhet të jetë me profil tubolar me seksion jo më të vogël se 20 x 20 mm, spesor jo më të vogël se 1.2 mm, e lyer me bojë elektrostатike ngjyrë sipas kërkesës së klientit. Në fundet e tyre të kenë tapa plastike për shmangien e zhurmave të ndryshme.

2. Karrige për nxënësit – Përmasat të jenë 35x38x42-45/75 cm.

- Mbështetëset dhe ulëset të jenë me material ferzalit, i derdhur në të gjithë trupin e ndenjësës dhe te shpinës. Materiali i derdhur i ferzalit duhet të jetë i qendrueshëm kundër lagështirës dhe gërvishtjeve.
- Ndenjësa dhe shpina të jenë të harkuara (me gropa në qendrën e ulëses dhe në formë anatomike). Skeleti duhet të jetë me profil tubolar oval ku në të dyja anët e tubit të jetë i rrumbullakosur, që të japi fortësinë dhe imazhin e dukshëm të karriges, me seksion jo më të vogël 30 x15 mm dhe spesor jo më të vogël se 1.2 - 1.5 mm.
- I gjithë skeleti të jetë i salduar me saldime të vazhduar me argon dhe i lyer me bojë elektrostатike, në pjesët fundore të ketë tapa plastike.

3. Tavolina për mësuesit - Përmasat të jenë 120x60x76 cm.

- Suprina të ndërtohet me pllake zdrukthi të melaminuar me trashësi 25 mm me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Përmasat e suprinës të jenë 120 x 60 cm.
- Veshja perimetrale e të gjithë elementëve përbërës të saj të jenë PVC 0.8 mm. Pjesët anësore të jenë të të njëjtit material me përmasa 70 x 60 cm dhe me spesor 18 mm.
- Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues dhe me tapa për të shmangur gërvishtjet me parketin ose pllakat. Bashkimi i suprinës me këmbët bëhet me aksesore të padukshëm.

4. Karrige për mësuesit - Përmasat e ulëses të jenë 45x40 cm ndërsa të mbështetësës (shpinores) 30x45 cm.

- Të ketë skelet metalik prej tubash çeliku me profil oval 30 x 15 mm, me spesor jo më të vogël se 1.3 cm me lyerje elektrostатike.
- Në pjesën e brendshme të ketë material plastik të cilësisë së lartë. Shpinorja dhe ndenjësja janë material plastik i cilësisë së lartë.
- Në pjesën e mbrapme të kenë një mbulesë prej polietileni e cila të montohet në skelet metalik me vida dhe mbushje gome sintetike me densitet të lartë.
- Tapiceria të jetë në stof të cilësisë së parë ose lëkure ekologjike.

5. Tabelë (dërrasë e zezë) – Me përmasa 120x180 cm.

- Të jetë sipërfaqe pllake zdrukthi e melaminuar me trashësi 1.6 cm me ngjyrë të zezë, ku mund të shkruhet me shkumës.
- E lehtë për t'u fshirë falë strukturës ekstra të imët të sipërfaqes. Sipërfaqe jo gërvishëse dhe rezistente.
- Ngjyrë e zezë mat me sipërfaqe jo reflektuese. Dorëzimi të bëhet duke përfshirë mbajtësen e shkumësave dhe kompletin e montimit.

6. Dollap/raft për klasa – Me përmasa jo më pak se 90x45x185 cm.

- Skeleti dhe sergjenet do jenë prej materiali pllake zdrukthi të melaminuar me trashësi jo më të vogël se 16 mm. Kapakët të jenë me material MDF me trashësi jo më të vogël se 16 mm, të borduar me PVC me trashësi jo më të vogël se 0.8 mm.
- Shpina e mobiljes me fibër jo më pak se 3 mm trashësi.
- Pjesa e përparme të jetë e mbyllur me 2 kapakë/kanata me hapje 90° të cilët të përmbajnë doreza dhe brava me çelës. Lart dhe poshtë të ketë shula për fiksimin e kanatave.
- Pjesa e brendshme të ndahet në 4 (katër) hapësira të barabarta me anë të 3 (tre) sergjeneve që janë të regjistrueshëm sipas nevojës.
- Dorezat dhe aksesoret e përdorur të jenë cilësorë.

7. Tavolinë ovale(mbledhje) për sallën e mësuesve – Me përmasa (gjerësi x thellësi x lartësi) të paktën 240x120x75 cm

- Suprina me pllakë zdrukthi të melaminuar me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave.
- Suprina e tavolinës përbëhet nga 4 elementë.
Dy elementë me përmasa 130 x 55 cm që vendosen paralelisht me njëri tjetrin duke lënë një hapësirë 10 cm midis tyre. Dy elementët e tjerë janë në përmasa 120 x 455 cm dhe janë në formë gjysmërrethi. Duke u vendosur përballë njëra tjetrës, në dy anët e ngushta të dy elementëve të parë i japin tavolinës një pamje ovale.
- Këmbët janë me plane të të njëjtit material dhe trashësi të suprinës.
- Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC me 0.8 mm trashësi. Bashkimi i planit të punës (suprinës) me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide.
- Aksesoret që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë.
- Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues.

8. Dollap dosjesh për sallën e mësuesve - Me përmasa jo më të vogla se: Lartësi 185 cm, Gjerësi 90 cm, Thellësi 45 cm.

- Skeleti dhe sergjenet do jenë prej materiali pllake zdrukthi të melaminuar me trashësi 18 mm. Kapakët janë me material MDF me trashësi 18 mm të borduar me PVC me trashësi 0.8 mm.
- Xokola do të jetë 8 cm e lartë dhe prej të njëjtit material.
- Poshtë fiankeve do ketë tapa fundore plastike kundër gërvishtjes. Në pjesën e poshtme deri në lartësinë 72 cm, do të ketë dy kapakë prej materiali melaminë, që mbyllen me çelës.
- Dollapi brenda këtyre dy kapakëve do jetë i ndarë në dy pjesë me anë të një sergjeni me lartësi të regjistrueshme.
- Pjesa e sipërme të jetë e mbyllur me kapakë xhami ose druri. Hapësira brenda kapakëve do të ndahet në tre hapësira me anë të dy sergjeneve
- Shpina e mobiljes me fiber 4 mm trashësi.
- Dorezat dhe aksesoret e përdorur të jenë cilësorë.

9. Dollap gardierë për stafin – Me përmasa jo më të vogla se: Lartësi 185 cm, Gjerësi 90 cm, Thellësi 45 cm.

- Skeleti të jetë prej materiali pllake zdrukthi të melaminuar me trashësi jo më pak se 18 mm.

- Xokula të jetë 6-8 cm e lartë me po të njëjtin material si skeleti.
- Pjesa e përparme të jetë e mbyllur me një ose 2 kapakë/kanata me hapje 90° të cilët të përmbajnë doreza dhe brava me çelës.
- Organizimi i brendshëm i dollapit është me raft ndarës në pjesën e sipërme, varëse rrobash tub dhe 2 sirtarë me lartësi 17 cm në pjesën e poshtme.
- Lidhja dhe montimi të bëhet me bulona të fshehur.
- Shpina e mobiljes të jetë fibër 4 mm trashësi.

10 Raft biblioteke – Me përmasa 90x40x185 cm. Me 4 ndarje horizontale.

- Konstruksioni do të jetë me pllakë zdrukthi të melaminuar me trashësi 18 mm me veshje perimetrale të plastifikuar me PVC me trashësi 0.8 mm.
- Rafti të ketë 4 ndarëse horizontale të brendshme. Ndarëset horizontale të raftit të jenë pllakë zdrukthi e melaminuar 25 mm me veshje perimetrale të plastifikuar me PVC 0.8 mm. Xokola do jetë 8 cm e lartë, e mbuluar dhe prej të njëjtit material.
- Trashësia prej 2.5 cm dhe gjatësia e lirë prej 90 cm është një gjatësi optimale, e cila siguron hapësirë të mjaftueshme gjithashtu ruan qëndrueshmërinë dhe nuk deformohet nën veprimin e ngarkesës së librave me kalimin e kohës.
- Shpina e raftit do të jetë fibër me trashësi 3 mm. Montimi të realizohet me aksesore të fshehur.

11. Tavolinë ovale për bibliotekën - Me përmasa (gjerësi x thellësi x lartësi) të paktën 240x120x75 cm

- Suprina me pllakë zdrukthi të melaminuar me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave.
- Suprina e tavolinës përbëhet nga 4 elementë.
- Dy elementë me përmasa 130 x 55 cm që vendosen paralelisht me njëri tjetrin duke lënë një hapësirë 10 cm midis tyre. Dy elementët e tjerë janë në përmasa 120 x 455 cm dhe janë në formë gjysmërrethi. Duke u vendosur përballë njëra tjetrës, në dy anët e ngushta të dy elementëve të parë i japin tavolinës një pamje ovale.
- Këmbët janë me plane të të njëjtit material dhe trashësi të suprinës.
- Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC me 0.8 mm trashësi. Bashkimi i planit të punës (suprinës) me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide.
- Aksesoret që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë.
- Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues.

12. Karrige biblioteke

- Lartësia totale 85 cm kurse lartësia e ndenjës nga dyshemeja jo më pak se 44 cm.
- Dimensionet e ndenjës jo më pak se 40 x 40 cm.
- Skeleti të realizohet nga dru ah masiv me seksion katror ose i rrumbullakët, i lyer me llak për të ruajtur ngjyrën natyrale të drurit.
- Ndenjësja të realizohet me pllake zdrukthi, sfungjer dhe stof. Në çdo rast duhet të sigurojnë një formë të harkuar.
- Në çdo rast do jetë e mbushur me sfungjer dhe e tapicuar me copë stofi ose lëkurë.

-
- Mbështetësja të realizohet me ristela të kurbëzuara jo më pak se dy ristela me gjerësi jo më pak se 5 cm ose një e vetme me gjerësi jo më pak se 10 cm.

13. Tavolinë për mësuesit për kabinetin e informatikës

- Përmasat e tavolinës për desktop: Suprina 140 x 70 x 75 cm
- Skeleti 135 x 65 x 72.5 cm. Skeleti është i ndërtuar me profil metalik tubolar me seksion katror 30 x 30 mm, me spesor jo më të vogël se 1.2 mm,
- Suprina e punës: pllakë zdrukthi e melaminuar 18 mm e borduar me PVC 0.8 mm që del mbi skelet
- Këmbët metalike janë të pajisur me vida rregullimi lartësie për të siguruar një nivel horizontal të pavarur nga mosnivelet e dyshemesë.
- Nën suprinë majtas ose djathtas është elementi mbajtës i njësive qendrore e bërë me material pllakë zdrukthi e melaminuar 18 mm me përmasa: 50 x 25 x 60 cm.
- Në krahun tjetër të vendosjes së Hardiskut (njësisë qendrore) janë të vendosur tre sirtarë, të cilët montohen nën suprinën e tavolinës me përmasa: Lartësia 15 cm, gjerësia 40 cm dhe thellësia 60 cm.

14. Tavolinë nxënësish dy vendëshe për kompjuter

- Përmasat e tavolinës për desktop: Suprina 140 x 70 x 75 cm
- Skeleti 135 x 65 x 72.5 cm. Skeleti është i ndërtuar me profil metalik tubolar me seksion katror 30 x 30 mm, me spesor jo më të vogël se 1.2 mm,
- Suprina e punës: pllakë zdrukthi e melaminuar 18 mm e borduar me PVC 0.8 mm që del mbi skelet
- Këmbët metalike janë të pajisur me vida rregullimi lartësie për të siguruar një nivel horizontal të pavarur nga mosnivelet e dyshemesë.
- Nën suprinë majtas ose djathtas është elementi mbajtës i njësive qendrore e bërë me material pllakë zdrukthi e melaminuar 18 mm me përmasa: 50 x 25 x 60 cm.

15. Karrige për kabinetin e informatikës

- Lartësia 85 cm kurse lartësia e ndenjës nga dyshemeja jo më pak se 44 cm.
- Dimensionet e ndenjës jo më pak se 40 x 40 cm.
- Skeleti të realizohet nga dru ah masiv me seksion katror ose i rrumbullakët, i lyer me lak për të ruajtur ngjyrën natyrale të drurit.
- Ndenjësja të realizohet me pllakë zdrukthi, sfungjer dhe stof. Në çdo rast duhet të sigurojnë një formë të harkuar. Në çdo rast do jetë e mbushur me sfungjer dhe e tapicuar me copë stofi ose lëkurë.
- Mbështetësja të realizohet me ristela të kurbëzuara jo më pak se dy ristela me gjerësi jo më pak se 5 cm ose një e vetme me gjerësi jo më pak se 10 cm.

16. Dollap për kabinet - Me përmasa (gjerësi x thellësi x lartësi) jo më pak se 90x45x185 cm.

- Skeleti dhe sergjenet do jenë prej materiali pllakë zdrukthi të melaminuar me trashësi 18 mm. Bordet anësore të skeletit, sergjenëve dhe kapakëve janë me material MDF me trashësi 18 mm të borduar me PVC me trashësi 0.8 mm. Poshtë të ketë këmbëza me mekanizëm nivelues.

- Në pjesën e poshtme deri në lartësinë 72 cm, do të ketë dy kapakë prej materiali melamine me trashësi 18 mm, që mbyllen me çelës.
- Dollapi brenda këtyre dy kapakëve do jetë i ndarë në dy hapësira me anë të një sergjeni me lartësi të regjistrueshme.
- Pjesa e sipërme është do jetë me kapakë xhami (që mund të jenë me ose pa kornizë druri). Hapësira brenda kapakëve të xhamit do ndahet në tre hapësira me anë të dy sergjeneve që janë të regjistrueshëm sipas nevojës.
- Dorezat dhe aksesoret e përdorur të jenë cilësorë.

17. Tavinë drejtuesi formë L-e vogël

- Të jetë e përbërë nga 3 pjesë kryesore:
1-Tavolina e punës (me gjatësi 140 cm, gjerësi 70 cm dhe lartësi 72 cm)
2-Tavolina e kompjuterit (me gjatësi 90 cm, gjerësi 70 cm dhe lartësi 72 cm)
3-Harku lidhës 90° me përmasa 70 x 70 cm
- Suprina pllake zdrukthi e melaminuar me trashësi 2.5 cm. Veshje laminate me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me material pllake zdrukthi e melaminuar trashësi 18 mm.
- Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC 0.8 mm.
- Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani i dyshemesë.
- Aksesoret që përdoren për montimin e elementeve të tavolinës të jenë cilësorë.
- Këmbët janë me material pllake zdrukthi e melaminuar trashësi 18 mm dhe me mekanizëm nivelues.
- Tavolina e punës në pjesën e brendshme të ketë të montuar në njërin krah një bllok sirtarësh ku sirtari i parë të jetë i mbyllur me çelës.

18. Karrige rrotulluese drejtuesi

- Karriget rrotulluese të kenë shpinore të regjistrueshme me mekanizëm për ulje-ngritje me piston.
- Karrigia do të mbështetet mbi një bazament në formë ylli me 5 rrota në forme sferike në ekstremet e tyre. Rrotat të jenë me material plastik ngarkesë-mbajtës.
- Krahët mbështetës të karriges të jenë plastikë dhe ngarkesë mbajtës.
- Tapiceria të jetë në stof të cilësisë së parë ose lëkurë ekologjike dhe e mbushur me material cilësor mbushës.

19. Dollap për arkivin – Me përmasa (gjerësi x thellësi x lartësi) 90x40x195 cm.

- Dollap metalik me dyer. Duhet të ketë strukturë prej çeliku të lyer që ti rezistojë korozionit dhe përkuljes.
- Dollapi duhet të sigurojë mbyllje me çelës.
- Përbëhet nga dy kanata me hapje 90 gradë.
- Pjesa e brendshme e dollapit ndahet në 5 hapësira.
- Sergjenet ndarës duhet të kenë përshtatje lartësie jo më shumë se 30 mm dhe të kenë aftësi mbajtëse jo më pak se 50 kg. Trashësia e llamarinës jo më pak se 0.9-1 mm

20. Tavolina rrethore për kopshtin – Me diametër 80 cm dhe lartësi 55 cm.

- Materiali i skeletit të jetë me konstruksion druri ahu i staxhionuar, e përpunuar dhe e latuar në të gjithë perimetrin e saj.
- Suprina e saj MDF e laminuar me trashësi 18 mm dhe bordet perimetrale të rrumbullakosur në pjesën e sipërme.
- I gjithë montimi bëhet me elementë të fshehur dhe jo të dukshëm.

21. Karrige për kopshtin – Me përmasa 55 x 29 x 32 cm.

- Skelet me konstruksion dru ahu i staxhionuar, i lyer me ngjyra të ndryshme.
- Ulësja me pllakë zdrukthi e veshur me sfungjer dhe tapiceri cilësore me ngjyra të ndryshme, mbështetësja e karriges e formësuar multistratë (kompesatë shumë shtresore).

Vërejtje: Për të gjithë pajisjet/mallrat e sipërlistuar, lejohet shmangie deri me 5% nga të dhënat e vendosura në specifikime.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Baza materiale	Njësia	Sasia
1	Tavolinë për nxënësit	copë	90
2	Karrige për nxënësit	copë	180
3	Tavolina për mësuesit	copë	15
4	Karrige për mësuesit me tapiceri	copë	40
5	Tabelë / dërrasë e zezë	copë	15
6	Dollap/raft për klasa	copë	15
7	Tavolinë ovale(mbledhje) për sallën e mësuesve	copë	2
8	Dollap për sallën e mësuesve	copë	2
9	Dollap gardërobë për stafin	copë	2
10	Raft biblioteke me 4 ndarje horizontale	copë	3
11	Tavolinë ovale për bibliotekën	copë	2
12	Karrige biblioteke	copë	20
13	Tavolinë për mësuesit për kabinetin e informatikës	copë	1
14	Tavolinë nxënësish dy vendëshe për kompjuter	copë	10
15	Karrige për kabinetin e informatikës	copë	20
16	Dollap për kabinet	copë	2
17	Tavolinë drejtuesi formë L-e vogël	copë	1
18	Karrige rrotulluese drejtuesi	copë	1
19	Dollap për arkivin	copë	1
20	Tavolina rrethore për kopshtin	copë	8
21	Karrige për kopshtin	copë	40

Vendi i dorëzimit: Shkolla 9-vjeçare “Hysen Xheka”, Lagjja Karbunarë e Poshtme, Lushnje

Afati i lëvrimit: 10 ditë (kalendarike) nga nënshkrimi i kontratës

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Certifikatë - ISO 9001 2015 për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ose objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim ose ekuivalentin e saj.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të 3 (tre) viteve të fundit (vitet financiare 2022, 2023, 2024) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter duhet të përmbushet nga i gjithë bashkimi në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë **kopje të certifikuara të balanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare** (2022, 2023, 2024) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave dhe të konfirmuara nga ky Autoritet. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter duhet të përmbushet nga i gjithë bashkimi në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin e fundit **2025 (këstet e maturuara)** pranë njësive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në përputhje me ligjin 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” kudo që operatori ekonomik ka ushtruar aktivitet sipas QKB. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Organi përkatës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë totale jo më të vogël se 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë, vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një katalog/skedë teknike ku të listohen mallrat objekt prokurimi që ky operator ofron, shoqëruar me specifikimet teknike dhe foto ilustruese për secilin

prej tyre, në mënyrë që të provohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike të mallrave sipas dokumentave standarde të tenderit.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një **deklaratë garancie**, me afat jo më pak se 12 muaj nga data e dorëzimit të pajisjeve/mallrave, me anë të së cilës garanton se mallrat do të jenë të reja, të papërdorura më parë dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë dhe merr përsipër të sigurojë riparimin ose zëvendësimin pa pagesë të mallrave që kanë defekte të shkaktuara gjatë prodhimit apo montimit.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se merr përsipër kryerjen e shërbimit të transportit të mallrave dhe dorëzimin në vendin e dorëzimit të rënë dakord me Autoritetin Kontraktor, deri në përfundim të dorëzimit të sasisë totale të mallrave dhe se ka në dispozicion mjetet e duhura për të kryer këtë transport.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Ky dokumentacionin origjinal ose në kopje të noterizuara, i cili vërteton përmbushjen e kritereve për kualifikim, duhet të dorëzohet pranë Autoritetit Kontraktor nga operatori ekonomik i renditur i pari, brenda 1 dite pune nga momenti i marrjes së njoftimit të klasifikimit nëpërmjet SPE.

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	_____
Numri NIPT/et:	_____
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	_____
Përfaqësuesi (emri):	_____
Telefoni:	_____
E-mail:	_____

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar
------------------------	---------	-----------------------------	---

të propozuar				• nformacion mbi subjektet
kytë mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik				
Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et	

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se:**

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër⁶.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

- a) çmimet;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;

⁶ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

